


DOKUMENT POLITIKASH



**“Mbrojtja e të Drejtave
të Njeriut në Epokën e
Inteligjencës Artificiale:
Qasjet e Legjislacionit të
BE-së dhe të Shqipërisë”**

Autorë

Andrea Mazelliu, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH)

Orkidea Xhaferaj, Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)

Erjon Curraj, Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)

Rishikuese:

Erida Skëndaj, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH)

Blerjana Bino, Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)

Tiranë, Nëntor 2025

Ky dokument është hartuar nga ekspertët e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH) dhe Qendrës Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) në kuadër të programit të Angazhimit të Shoqërisë Civile në Integrimin Europian – Cluster 1 – dhe me mbështetjen e Ambasadës së Vendeve të Ulta në Shqipëri.

PËRMBAJTJA

Shkurtime	3
Përmbledhje ekzekutive	4
I. HYRJE	6
1.1 Konteksti	6
1.2 Qasja metodologjike	6
1.3 Ekspertiza institucionale dhe qasja ndërdisiplinore	7
1.4 Karakteri i dokumentit dhe nevoja për debat të qëndrueshëm publik.....	7
1.5 Struktura e dokumentit	8
II. Të drejtat e njeriut dhe inteligjenca artificiale	9
III. Inteligjenca Artificiale në Shqipëri, SFIDAT E KONSOLIDIMIT ligjor dhe rRegullator	10
3.1 Kuadri ligjor dhe rregullator mbi Inteligjencën Artificiale në Shqipëri	10
3.2 Praktikrat aktuale të përdorimit të AI në Shqipëri	14
IV. Regullimi i Sistemeve të Inteligjentës Artificiale në Bashkimin EUropan	19
4.1 Pikënisja për rregullimin e IA-së në BE.....	19
4.2 Mbi Aktin e Bashkimit Evropian për Inteligjencën Artificiale	20
4.3 Të drejtat themelore dhe rreziqet e përdorimit të sistemeve IA	21
4.4 Konventa Kuadër e KiE-së për Inteligjencën Artificiale.....	23
V. REKOMANDIME	25
5.1 Masa tranzitore për rregullimin e IA-së në Shqipëri	25
5.2 Masa afatgjata të qeverisjes së IA-së.....	26

Shkurtime

AKSHI – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

AKSK – Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike

BE – Bashkimi Evropian

CSIRT – Computer Security Incident Response Team (Ekipi Kombëtar për Reagim ndaj Incidenteve Kibernetike)

DSA – Digital Services Act (Akti i Shërbimeve Dixhitale)

EU AIA – Akti i Bashkimit Evropian për Inteligjencën Artificiale

FOI – Freedom of Information (Kërkesë për të Drejtën e Informimit)

GDPR – General Data Protection Regulation (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave)

GPAI – General-Purpose Artificial Intelligence (Inteligjencë Artificiale me Qëllim të Përgjithshëm)

IA – Inteligjencë Artificiale

KShH – Komiteti Shqiptar i Helsinkit

MIE – Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës

MoU – Memorandum of Understanding (Memorandum Mirëkuptimi)

NIS2 – Network and Information Security Directive 2 (Direktiva e Bashkimit Evropian për Sigurinë e Rrjeteve dhe Informacionit)

QBZ – Qendra e Botimeve Zyrtare

SCiDEV – Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim

SOP – Standard Operating Procedure (Procedurë Standarde Operimi)

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përdorimi i inteligjencës artificiale (IA) në Shqipëri po rritet me ritme të shpejta, duke u bërë pjesë e qeverisjes digjitale dhe e transformimit institucional. Megjithëse këto zhvillime përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të administratës dhe shërbimeve publike, ato ende po ndodhin në mungesë të një kuadri të plotë ligjor, etik dhe institucional që garanton plotësisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, transparencën dhe përgjegjësinë publike. Ky dokumenti politikash paraqet një analizë të parë të këtij lloji në Shqipëri, duke vlerësuar situatën aktuale, kornizën ligjore dhe institucionale, praktikën ekzistuese dhe përafrimin me standardet evropiane të qeverisjes së IA-së.

IA po ndikon në çdo aspekt të jetës shoqërore duke sjellë njëkohësisht mundësi dhe rreziqe. Përdorimi i saj pa garanci të forta ligjore mund të cenojë privatësinë, të çojë në përpunim të padrejtë të të dhënave, diskriminim algoritmik, manipulim të përmbajtjeve apo survejim të gjerë të qytetarëve. Në mungesë të mekanizmave për mbikëqyrje të pavarur, vendimmarrja automatike dhe përdorimi i modeleve të IA-së në fushat publike rrezikon të dobësojë parimet e shtetit të së drejtës dhe llogaridhënies. Dokumenti nënvizon se çdo zhvillim i IA-së duhet të mbështetet në parimin e mbrojtjes së të drejtave themelore si bazë e besueshmërisë teknologjike dhe e qeverisjes demokratike.

Rregullimi i IA-së në Shqipëri është ende në fazë fillestare. Kuadri aktual bazohet kryesisht në Ligjin nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, Metodologjinë e Standardeve Teknike për Përdorimin e Inteligjencës Artificiale, Ligjin nr. 16/2024 “Për Prokurimin Publik” si dhe Ligji nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Këto instrumente ofrojnë udhëzime teknike, por jo detyrime të qarta ligjore dhe nuk parashikojnë mekanizma të mbikëqyrjes, përgjegjësisë apo vlerësimit të ndikimit mbi të drejtat e njeriut. Metodologjia për IA mbetet dokument orientues, pa forcë detyruese, duke patur kështu riskun e krijimit të pasigurisë juridike në përdorimin e sistemeve të rrezikut të lartë. Draft Strategjia Kombëtare e Inteligjencës Artificiale 2030, e konsultuar publikisht, përbën hapin e parë drejt një vizioni kombëtar për zhvillimin e IA-së në Shqipëri, por është ende e pamiruar dhe pritët të miratohet brenda tre muajve të parë 2026. Ndërkohë, disa iniciativa si “Diella”, asistencja virtuale e e-Albania, dhe më pas paraqitja e saj si Ministre Shteti me IA për Prokurimin Publik, përdorimi i IA-së në përafrimin ligjor me *acquis*-in e Bashkimit Evropian, apo në menaxhimin e projekteve të “Smart City”, janë zbatuar pa bazë të qartë ligjore dhe pa analizë të plotë të riskut sa i takon ndikimit tek të drejtat e njeriut sipas evidencave të disponueshme deri tani.

Analiza tregon se, ndonëse Shqipëria ka ndërmarrë hapa drejt integritetit të IA-së në sektorin publik, procesi po zhvillohet në kuadër ligjor dhe rregullator ende fillestar. Kuadri ekzistues ligjor nuk garanton mbrojtje të plotë të të drejtave të njeriut, ndërsa transparenca dhe mbikëqyrja e përdorimit të sistemeve të IA-së mbeten të pa artikuluar. Rreziku kryesor i institucionalizimit të teknologjive të IA-së pa bazë ligjore të qartë dhe pa mekanizma të llogaridhënies dhe transparencës qëndron në krijimin e terrenit për abuzim në përdorimin e këtyre teknologjive si diskriminim algoritmik, abuzimi me të dhënat personale apo survejimi.

Dokumenti propozon një sërë masash për fazën tranzitore dhe afatgjatë të qeverisjes së IA-së në Shqipëri. Në periudhën afatshkurtër, kërkohet miratimi i një metodologjie për vlerësimin e ndikimit mbi të drejtat themelore të sistemeve të IA-së, vendosja e klauzolave të transparencës në kontratat ekzistuese, dhe krijimi i grupeve ndërinstitucionale shumëpalëshe me përfshirjen e institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile si dhe nënshkrimi dhe ratifikimi i Konventës së Këshillit të Evropës.

Në periudhën afatgjatë, rekomandohet miratimi i një kuadri ligjor të plotë dhe gjithëpërfshirës për IA-në, përafrimi dhe harmonizimi me Aktin e BE-së për AI-në duke përfshirë krijimi i një Autoriteti të Pavarur Mbikëqyrës për Inteligjencën Artificiale me kompetenca inspektimi dhe sanksionimi; krijimi i një Regjistri Kombëtar Publik të Algoritmeve për transparencë; si dhe kryerja e auditimeve vjetore të pavarura për sistemet e IA-së me rrezik të lartë sipas parashikimeve të Aktit të BE-së për IA-në. Gjithashtu, theksohet nevoja për një Strategji Kombëtare për të Ardhmen e Punës në Epokën e IA-së, që të parashikojë ndikimin e teknologjisë në tregun e punës dhe aftësitë e nevojshme për transformimin digjital.

Dokumenti konkludon se Shqipëria ndodhet në një moment kritik për qeverisjen e inteligjencës artificiale. Zhvillimet teknologjike po përparojnë me një ritëm më të shpejtë se aftësia institucionale për t'i kuptuar, rregulluar dhe mbikëqyrur ato. Kjo mospërputhje krijon rreziqe të prekshme për të drejtat e njeriut dhe besimin publik, por njëkohësisht hap një mundësi të rëndësishme për ndërtimin e një modeli qeverisjeje të bazuar në parimet e shtetit të së drejtës, transparencës dhe demokracisë përfshirëse. Në këtë kuptim, Shqipëria duhet të ndërtojë një kuadër ligjor dhe institucional të qëndrueshëm, që garanton se përdorimi i IA-së zhvillohet mbi bazën e të drejtave të njeriut, etikës dhe llogaridhënies publike dhe në linjë me standardet europiane.

I. HYRJE

1.1 Konteksti

Zhvillimet e vrullshme në fushën e inteligjencës artificiale po ndryshojnë ndjeshëm mënyrën se si qeveritë, ekonomitë dhe qytetarët ndërveprojnë me teknologjinë. Sistemet e bazuara në IA tashmë ndikojnë në vendimmarrje publike dhe private, në mënyrën si ofrohen shërbimet, si përpunohen të dhënat dhe si zhvillohet komunikimi institucional. Potenciali i tyre për rritjen e efikasitetit dhe inovacionit është i pamohueshëm, por në mungesë të një kuadri ligjor, rregullator, etik dhe institucional të qartë, si dhe standardeve të mirëpërcaktuara dhe të zbatueshme, këto zhvillime mbartin rreziqe serioze për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit.

Në Shqipëri, përdorimi i IA-së po zgjerohet përmes integritit në qeverisje si psh në sistemin e prokurimit publik.¹ Megjithatë, në këtë fazë ky proces po zhvillohet në mungesë të një kornize gjithëpërfshirëse ligjore dhe rregullatore që të garantojë mbrojtjen e të drejtave themelore, transparencën, përgjegjësinë dhe llogaridhënien. Zhvillime të tilla si “Diella”, asistentes virtuale të e-Albania, dhe më pas paraqitja e saj si Ministre Shteti për Inteligjencën Artificiale, përdorimi i IA-së në përafrimin ligjor me *acquis*-in e Bashkimit Evropian, apo në menaxhimin e projekteve të “Smart City”, dëshmojnë për një tendencë drejt modernizimit institucional, por edhe për boshllëqe të theksuara në aspektin e sigurisë juridike dhe mbikëqyrjes demokratike të teknologjisë.

Ky dokument politikash e trajton rregullimin e inteligjencës artificiale jo si një çështje thjesht teknologjike, por si një provë për kapacitetin institucional dhe demokratik të vendit për të garantuar që transformimi digjital të mbetet në shërbim të njeriut. Qëllimi kryesor është të kontribuojë në një analizë të bazuar në evidenca mbi gjendjen aktuale të përdorimit të IA-së në Shqipëri, në raport me standardet e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës sa i takon ndikimit tek të drejtat e njeriut, dhe të nxisë një debat publik të informuar mbi mënyrën se si duhet ndërtuar arkitektura ligjore dhe institucionale për qeverisjen e IA-së.

1.2 Qasja metodologjike

Dokumenti është përgatitur mbi bazën e një metodologjie analitike të kombinuar, që ndërthur analizën e dokumenteve dhe kërkesat për informacion (FOI). Hulumtimi i dokumenteve përfshiu analizën e legjislacionit ekzistues, akteve nënligjore, vendimeve të Këshillit të Ministrave, dokumenteve strategjike dhe materialeve të institucioneve publike e ndërkombëtare që trajtojnë qeverisjen e IA-së. U shqyrtuan, ndër të tjera, Ligji nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, Ligji nr. 16/2024 “Për Prokurimin Publik”, “Metodologjia e Standardeve Teknike për Përdorimin e

¹ Qeveria Shqiptare po zhvillon një Platformë të re të Prokurimit Publik Digjital me mbështetjen e Bankës Botërore. Sipas informacionit nga AKSHI, kjo platformë do të integrojë teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale, duke rritur transparencën, efikasitetin dhe llogaridhënien në proceset e prokurimit publik.

Inteligjencës Artificiale”, Ligji nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, dhe Draft Strategjia Kombëtare e Inteligjencës Artificiale 2030.

Paralelisht, ekipi kërkimor dërgoi kërkesa për informacion (FOI) pranë institucioneve publike që përdorin ose zhvillojnë teknologji të IA-së, si Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Ministria e Brendshme, për të siguruar transparencë mbi kontratat, kostot, vlerësimet e riskut dhe mekanizmat e mbrojtjes së të dhënave. Përgjigjet e pjesshme ose mungesa e tyre ilustronë nivelin ende të kufizuar të hapjes institucionale për qeverisjen e IA-së dhe nevojën për forcimin e llogaridhënies publike në këtë fushë. Drafti u konsultua në një tryezë konsultimi me pjesëmarrjen e institucioneve përkatëse dhe përfaqësuesve të Kuvendit, dhe më pas u rishikua në bazë të komenteve të marra nga përfaqësues të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtës së Informimit, si dhe të komenteve të përcjella me shkrim nga AKSHI.²

Gjithashtu, analiza është mbështetur gjithashtu në dokumente orientuese ndërkombëtare si Akti i Bashkimit Evropian për Inteligjencën Artificiale (EU AIA) dhe Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Sundimin e Ligjit, me qëllim që gjetjet dhe rekomandimet të përafrohen me standardet evropiane të qeverisjes digjitale dhe mbrojtjes së të drejtave.

1.3 Ekspertiza institucionale dhe qasja ndërdisiplinore

Ky dokument është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) dhe Qendrës Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV), dy organizatave që sjellin ekspertizë plotësuese në fushat e të drejtave të njeriut dhe qeverisjes digjitale. KShH ka një traditë të konsoliduar në monitorimin e zbatimit të të drejtave themelore dhe sundimit të ligjit, ndërsa SCiDEV ka ekspertizë në analizat ligjore dhe politikave për digjitalizimin, AI-në, dhe sigurinë kibernetike, ndër të tjera. Ky kombinim i perspektivave ligjore dhe teknologjike ka mundësuar një analizë të thelluar të ndërveprimit midis inovacionit dhe përgjegjësisë, duke e pozicionuar dokumentin si një kontribut të parë të strukturuar në debatin publik mbi qeverisjen e IA-së, por padyshim jo një dokument shterues.

Të dy organizatat kanë zhvilluar kërkime dhe advokim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, në fushat përkatëse, duke sjellë në këtë analizë jo vetëm njohuritë e tyre institucionale, por edhe përvojën praktike në ndërtimin e politikave të bazuara në evidenca dhe në dialog të hapur ndërmjet institucioneve, shoqërisë civile dhe komunitetit profesional.

1.4 Karakteri i dokumentit dhe nevoja për debat të qëndrueshëm publik

Ky dokument përfaqëson analizën e parë të këtij lloji në Shqipëri që lidh drejtpërdrejt zhvillimin e IA-së me implikimet e saj për të drejtat e njeriut dhe qeverisjen demokratike. Ai nuk synon të japë përgjigje përfundimtare, por të vendosë bazat për një debat të informuar, gjithëpërfshirës dhe shumëpalësh mbi mënyrën e zhvillimit dhe rregullimit të IA-së në vend. Duke qenë një nismë e parë analitike, dokumenti duhet të shihet si një draft themelor, që kërkon plotësim me të dhëna

² <https://scidevcenter.org/2025/11/24/summary-of-roundtable-protecting-human-rights-in-the-age-of-artificial-intelligence-eu-and-albanian-legislation-approaches/>

empirike, kërkime të reja dhe monitorim të vazhdueshëm të praktikave institucionale në përfshirjen e teknologjive të reja në politikëbërje dhe administrim publik.

Përmes një procesi të qëndrueshëm dhe transparent, i mbështetur në bashkëpunimin ndërmjet qeverisë, institucioneve të pavarura, akademisë, sektorit privat dhe shoqërisë civile, mund të ndërtohet një qasje e besueshme dhe e përgjegjshme për qeverisjen e inteligjencës artificiale në Shqipëri. Një debat i tillë duhet të shërbejë për të përcaktuar balancën midis inovacionit dhe mbrojtjes së të drejtave themelore, duke e vendosur teknologjinë në funksion të qytetarit dhe jo anasjelltas.

1.5 Struktura e dokumentit

Dokumenti është i ndarë në katër kapituj analitikë që ndërtojnë një linjë të qartë argumentuese. Pjesa e parë shqyrton marrëdhënien midis të drejtave të njeriut dhe IA-së. Pjesa e dytë analizon kuadrin ligjor dhe institucional të IA-së në Shqipëri, boshllëqet rregullatore dhe praktikat ekzistuese. Pjesa e tretë trajton rregullimin e sistemeve të IA-së në Bashkimin Evropian dhe Këshillin e Evropës, me fokus te Akti i BE-së për IA dhe Konventa Kuadër e KiE-së. Pjesa e katërt përmbledh rekomandimet kryesore, të ndara në masa tranzitore dhe masa afatgjata, që synojnë përfrimin me standardet evropiane dhe ndërtimin e një qasjeje të qëndrueshme të qeverisjes së IA-së në Shqipëri.

II. TË DREJTAT E NJERIUT DHE INTELIGJENCA ARTIFICIALE

Teknologjitë e IA-së po zhvillohen me hapa shumë të shpejtë, duke rikonfiguruar mënyrën e të punuarit, të të nxënit dhe të të jetuarit. Këto teknologji ndikojnë çdo aspekt të jetës njerëzore, nga dhënia dhe marrja e shërbimeve publike, kujdesi shëndetësor, arsimi, transporti, tek vendimmarrja, si personale ashtu edhe publike. Përdorimi i IA-së mundëson rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të qeverisjes, por njëkohësisht sjell një seri sfidash serioze për të drejtat e njeriut³. Andaj, ndërkohë që institucionet zhvillojnë dhe përdorin IA-të nevojitet një rregullim i mirë, i plotë dhe i qartë ligjor, dhe mbikëqyrje shumëpalëshe e zbatimit të këtyre teknologjive.

Një nga rreziqet më të mëdha të përdorimit të teknologjive të IA-së është cënimi i privatësisë, duke përfshirë rrjedhjen e të dhënave, aksesin e paautorizuar, keqpërdorimin e të dhënave⁴. Për më tepër, rritja e përdorimit dhe masivizimit të teknologjive të IA-së, si pjesë e proceseve të transformimit digjital, rrit probabilitetin e sulmeve kibernetike, dhe si pasojë mundësitë e rrjedhjes së të dhënave⁵.

Cënimi i lirisë së shprehjes nga teknologjitë e IA-së⁶ ka shfaqje të ndryshme, duke nisur nga llojet e informacionit me të cilat ushqehen modelet, përdorimi i IA-së në rrjetet sociale në moderimin e përmbajtjes, tek gjenerimi i përmbajtjeve *deepfake*, që cënojnë edhe aspekte të tjera të dinjitetit njerëzor deri tek të drejtat e autorësisë. Përdorimi i tyre sjell rreziqe të qënësishme për demokracinë dhe shtetin ligjor.

Teknologjitë e IA-së mund të përdoren për survejimin e qytetarëve, si nëpërmjet kamerave me rezolucion të lartë, identifikimit biometrik, monitorimit të sjelljeve në rrjetet sociale, apo përndjekjen digjitale. Edhe pse survejimi mund të kontribuojë në parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit, nëse keqpërdoret dhe aplikohet pa garancitë e duhura, mund të ndjekje penale të gabuar ose profilizim të padrejtë të qytetarëve. Për më tepër, survejimi sjell rreziqe të drejtpërdrejta për privatësinë dhe lirinë e shprehjes së qytetarëve.

Duke qënë se sistemet e IA-së mësojnë nga të dhënat ekzistuese, kur këto të dhëna përmbajnë paragjykimë gjinore apo socio-ekonomike, produktet e gjeneruara nga këto sisteme shkaktojnë diskriminim, me rrezikun për të riprodhuar edhe madje edhe thelluar pabarazitë.

Së fundi, përdorimi i teknologjive të IA-së po revolucionon tregun e punës dhe mbart rrezikun e zhdukjes së shumë profesioneve si dhe evolucionin e të tjerave. Nëse nuk merren masa mitiguese rreziqet për thellimin e pabarazive dhe rritjen e sfidave për punë të denjë rriten.

Në këtë kuadër, është e domosdoshme që vendet që përdorin dhe zhvillojnë teknologji të inteligjencës artificiale të marrin masat e nevojshme, afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, për

³ Council of Europe. (2021). *Human Rights and Artificial Intelligence*

⁴ Paul, J. (2024, November). *Privacy and data security concerns in AI*.

⁵ Global Cyber Security Netöork. (2025, March 21). *Ëhy are cyber attacks on the rise? Causes, threats, and protection tips*.

⁶ UNESCO and UNDP (2025). *Freedom of expression, artificial intelligence and elections*.

të mitiguar efektin e këtyre teknologjive tek të drejtat themelore të njeriut. Sistemet dhe zgjidhjet duhet të ndjekin qasjen që në themel të tyre të kenë mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut.

Duke konsideruar fuqinë dhe efektin e përdorimit të këtyre teknologjive për demokracinë dhe shtetin ligjor, qasja e zhvillimit bazuar në të drejtat dhe liritë themelore, përbën hapin e parë mitigues.

III. INTELIGJENCA ARTIFICIALE NË SHQIPËRI, SFIDAT E KONSOLIDIMIT LIGJOR DHE RREGULLATOR

3.1 Kuadri ligjor dhe rregullator mbi Inteligjencën Artificiale në Shqipëri

Rregullimi i përdorimit dhe zhvillimit të teknologjive të IA-së në Shqipëri është ende në fazë embrionale. Aktualisht, në bazë të këtij rregullimi qëndrojnë ndryshime të ligjit nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, i ndryshuar, Metodologjia e Standardeve Teknike për Përdorimin e Inteligjencës Artificiale, ligji nr. 16/2024 “Për Prokurimin Publik” dhe ligji nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Ligji nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike,”⁷ i ndryshuar përkufizon se *inteligjenca artificiale është simulimi i proceseve të inteligjencës njerëzore nëpërmjet sistemeve dhe algoritmeve kompjuterike*. Neni 39 i ligjit, “Përdorimi i teknologjisë së integjencës artificiale” përcakton:

1. Teknologjia e inteligjencës artificiale aplikohet, aty ku është e mundur, në sistemet elektronike të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit me qëllim rritjen dhe inovacionin në ekonominë digjitale.
2. Metodologjia dhe standardet teknike të përdorimit të kësaj teknologjie përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përveç sa më sipër, ligji nuk shprehet mbi rregullimin e teknologjive të inteligjencës artificiale.

Në vitin 2024, sipas përcaktimeve të mësipërme, Këshilli i Ministrave miratoi dokumentin e **Metodologjisë dhe Standardet Teknike për Përdorimin e Inteligjencës Artificiale në Republikën e Shqipërisë**.⁸ Vendimi ngarkon Angjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), ministritë dhe institutionet e tjera publike për zbatimin e tij.

Metodologjia ka për objekt ofrimin e një qasjeje sistemike dhe të strukturuar për zhvillimin, zbatimin dhe menaxhimin e teknologjive të itneligjancës artificiale. Ajo siguron një udhëzues të qartë dhe efektiv për përcaktimin e veprimeve dhe masave që so të ndërmerren për të garantuar një implementim të suksesshëm dhe të sigurt të teknologjive të reja të inteligjencës artificiale.

Metodologjia përcakton standardet teknike, kërkesat për menaxhimin e riskut, sigurinë e ciklit jetësor të sistemeve të IA-së, integritetin e të dhënave, sigurinë kibernetike dhe kontrollin e zinxhirit të furnizimit. Ajo klasifikon sistemet IA të ndara në katër kategori sipas nivelit të riskut: (i)

⁷ <https://qbz.gov.al/preview/9fb689d7-75d3-4621-a5a4-dab6e3a52d93>

⁸ <https://qbz.gov.al/preview/9832489f-185c-43e6-a5a3-f905d53db219>

rrezik i papranueshëm - sistemet e IA-së që shkelin në thelb vlerat dhe të drejtat themelore të BE-së; (ii) rrezik i lartë - përfshijnë teknologjinë IA të përdorur në infrastruktura kritike që mund të rrezikojë jetën dhe shëndetin e qytetarëve; trajnim arsimor ose profesional, që mund të përcaktojë qasjen në arsim dhe karrierë; komponentët e sigurisë së produkteve; punësim dhe menaxhim të punonjësve; shërbime private dhe publike thelbësore; zbatimi i ligjit; menaxhimi i migracionit, azilit dhe kontrollit kufitar; administrimi i drejtësisë dhe proceseve demokratike; (iii) rrezik i kufizuar - sisteme të IA-së paraqesin kërcënime minimale, por ende kërkojnë njëfarë niveli të ndërgjegjësimit të përdoruesit. Për shembull, kur përdoren sisteme IA, si *chatbotet*, njerëzit duhet të jenë të vetëdijshëm që po ndërveprojnë me një makinë; ; (iv) rrezik minimal ose asnjë rrezik: Kjo kategori përfshin sistemet e IA-së me praktikisht asnjë rrezik për sigurinë, privatësinë ose të drejtat. Përfshirja e IA-së në aplikacione si videolojërat, filtrat e postës elektronike dhe sisteme të ngjashme.

Gjithashtu, metodologjia përcakton që procesi i menaxhimit të riskut dhe rezultatet e tij duhet të administrohen përmes politikave dhe procedurave transparente.

Standardet etike të parashikuara nga Metodologjia theksojnë mbrojtjen e privatësisë, sigurinë, transparencën, përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen njerëzore. Përdorimi i IA-së duhet të jetë i përputhshëm me të drejtat themelore dhe të drejtat e njeriut, duke shmangur çdo formë diskriminimi apo keqpërdorimi të të dhënave.

Megjithatë, qasja makromenaxhuese dhe makroorientuese e këtij dokumenti për implemetimin e zgjidhjeve të reja të inteligjencës artificiale krijon hapësirë pasigurie në raport me rreziqet që sjell përdorimi i IA-së. Për më tepër, gjuha e përdorur në VKM *‘veçanërisht atyre që prekin institucionet publike nën varësinë e Këshillit të Ministrave’* krijon mundësi për keqinterpretim në lënien jashtë të zgjidhjeve IA për sektorët jopublik.

Ligji nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”⁹ parashikon se autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane. Gjithashtu, ligji i ndryshuar për prokurimin publik parashikon se sistemi dinamik i blerjes dhe ankandi elektronik duhet të zhvillohen duke përdorur teknologji të avancuar të IA-së dhe procese të robotizuara. Po ashtu, ligji parashikon ndërtimin e sistemit të ankesave elektronike, që duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

Në kuptimin e autorëve, ligji për prokurimin publik lë një hapësirë ambiguiteti sa i përket përgjegjësisë finale mbi produktet dalë nga proceset e përdorimit të inteligjencës artificiale në prokurimin publik, duke mos përfshirë një nga parimet etike të artikuluara në metodologjinë prezantuar më sipër, që parashikon: institucionet të sigurojnë që sistemet e inteligjencës artificiale nuk zëvendësojnë përgjegjësinë dhe llogaridhënien përfundimtare njerëzore. Për më tepër, përdorimi i inteligjencës artificiale në prokurimin publik bërë në mungesë të një kuadri të

⁹ <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/02/08/16>

plotë ligjor, etik dhe institucional që garanton mbikëqyrje, transparencë dhe përgjegjësi njerëzore, sjell rrezeqe për automatizim të paragykimeve, manipulim algoritmik, dhe mungesë llogaridhënieje. Përfshirja e IA-së në pezullimin automatik të procedurave të prokurimit mund të cenojë parimin e sigurisë juridike dhe të drejtës për mjet efektiv ankimi, nëse vendimarrja automatike nuk shoqërohet me transparencë të plotë, akses publik në të dhëna dhe ndërhyrje njerëzore në rast gabimesh.¹⁰

Ligji nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”¹¹, harmonizuar plotësisht me GDPR dhe Direktivën nr. 680/2016 përmban dispozita që rregullojnë vendimarrjen e automatizuar.

Neni 13 i ligjit detyron kontrolluesit të informojnë subjektet për ekzistencën dhe logjikën e vendimarrjes automatike dhe profilizimit, si dhe për rëndësinë dhe pasojat e parashikuara të këtij përpunimi. Ndërsa neni 20 i ligjit parashikon se subjektet e të dhënave kanë të drejtë të mos jenë subjekt i një vendimi që bazohet vetëm në përpunimin automatik të të dhënave, përfshirë profilizimin, i cili shkakton pasoja ligjore ose pasoja të ngashme të rënda mbi të.

Neni 53 ndalon marrjen e vendimeve të bazuara vetëm tek pëpunimi automatik, përfshirë profilizimin të cilat sjellin pasoja ligjore negative për subjektin e të dhënave.

Neni 31 i ligjit parashikon Kur një lloj përpunimi, veçanërisht përpunimi duke përdorur teknologji të re, bazuar në natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, mund të shkaktojë një rrezik të lartë të cenimit të të drejtave dhe lirive themelore të individëve, kontrolluesi, përpara se të fillojë përpunimin, kryen vlerësimin e ndikimit të veprimeve të parashikuara të përpunimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale. Duhet theksuar se neni 31 hyn në fuqi në dhjetor të vitit 2026.

Draft Strategjia Kombëtare e Inteligjencës Artificiale 2030¹² e konsultuar publikisht¹³ përbën dokumentin e parë të publikuar që shpalos vizionin e qeverisë për fuqizimin e vendit në mënyrë digjitale, ku IA-ja do të jetë motori nxitës i rritjes ekonomike, përparimit shoqëror dhe përsosmërisë së shërbimeve publike. Strategjia pritët të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2026¹⁴.

Draft Strategjia parashikon se deri në vitin 2030 Shqipëri do të zhvillojë kapacitete të nivelit botëror të IA-se, integrojë atë në të gjitha sektorët, vendosë infrastrukturë të qendrueshme, sigurojë IA-në etike dhe përfshirëse, dhe nxisë një ekonomi bashkëpunuese të inteligjencës artificiale. Sigurimi i IA-së etike përfshin krijimin e një ekosistemi përgjegjës i IA-së ku etika, transparenca dhe gjithëpërfshirja janë themelore. Strategjia përcakton se qeverisja e IA-së në Shqipëri do të mbrojë të drejtat e qytetarëve, do të sigurojë që sistemet e IA-së të jenë të drejta dhe të shpjegueshme, si dhe do të promovojë një IA që sjell përfitime për të gjitha komunitetet.

Draft Strategjia identifikon tetë zona me potencial të lartë për zbatimin e IA-së: 1. Shëndetësi, 2. Arsimit, 3. Bujqësi, 4. Transport, 5. Monitorimi mjedisor dhe qendrueshmeria ndaj klimës, 6. Trashëgimia kulturore dhe turizmi, 7. Shërbimet publike dhe angazhimi i qytetarit, dhe 8. Energjia.

¹⁰ Shih gjithashtu <https://ais.al/new/wp-content/uploads/POSITION-PAPER-AIS-PUBLIC-PROCUREMENT.pdf> dhe <https://citizens.al/en/2024/01/23/ndryshim-i-parakohshem-ligji-i-ri-per-prokurimet-publike-pritet-me-kritika/>

¹¹ https://kpa.al/wp-content/uploads/2025/02/Ligj-nr.-124-2024-Per-mbrojtjen-e-te-dhenave-personale-1_.pdf

¹² <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/864>

¹³ Deri në publikimin e këtij dokumenti dhe informacionin e disponueshëm, Draft Strategjia nuk është miratuar ende.

¹⁴ Sipas komenteve të dorëzuar nga AKSHI grupit kërkimor pas konsultimit të draft dokumentit.

Draft Strategjia përcakton gjashtë shtylla bazë që do të mbështesin zhvillimin, zbatimin, përdorimin dhe monitorimin e IA-së: 1. Infrastrukturë dhe Ekosistem; 2. Inteligjenca Artificiale në Industri; 3. Arsimi dhe Zhvillimi i Fuqisë Punëtore; 4. Korniza Ligjore; 5. Të dhënat si një faktor strategjik mundësues; 6. Bashkëpunimi Ndërkombëtar.

Nën shtyllën katër, korniza ligjore, shtjellohen më tej parime dhe masa të parashikuara për t'u ndërmarrë në mbrojtje të të drejtave të njeriut, si: - përcaktimi i një grupi parimesh etike që udhëheqin zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive të IA-së; - transparenca: parimi i bërjes së të dhënave, metodave dhe rezultateve të sistemeve të inteligjencës artificiale të aksesueshme dhe të kuptueshme për palët e interesuara përkatëse, siç janë zhvilluesit, përdoruesit, rregullatorët dhe publiku; - qeverisja dhe mbikëqyrja: krijimi i kuadrove rregullatore që përcaktojnë rolet, përgjegjësitë dhe detyrimet e aktorëve të ndryshëm të përfshirë në ciklin e jetës së inteligjencës artificiale, si zhvilluesit, ofruesit, përdoruesit dhe rregullatorët; siguria e të dhënave dhe privatësia: përcaktimi i rregullave dhe standardeve për mbrojtjen e të dhënave; - barazi, drejtësi dhe mosdiskriminim: vendosja e udhëzimeve dhe standardeve për mbledhjen dhe analizën e të dhënave, projektimin dhe testimin e algoritmeve, si edhe vlerësimin dhe auditimin e sistemeve të IA-së.

Draft Strategjia gjithashtu parashikon përgatitjen e kuadrit ligjor për sandboxes rregullatore¹⁵ të inteligjencës artificiale, i cili do të harmonizohet me Aktin e Inteligjencës Artificiale të BE-së. Ky kuadër, sipas planit të veprimit të strategjisë parashikohet që në vitin 2025 do të përgatiten rregulloret sandbox për IA-në.

Harmonizimi i kuadrit ligjor me Aktin e Inteligjencës Artificiale të BE-së (AI Act)

Në kuadër rekomandimeve të BE_së dhe në zbatim të prioritetëve të përcaktuara në Dokumentin e Qëndrimit të Përbashkët¹⁶ për Grupkapitullin III – “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse,”¹⁷ Kapitulli 10 “Transformimi Digjital dhe Media”, Qeveria ka përgatitur një plan pune fillestar, i cili parashikon:

- Analizimin e përmbajtjes së Aktit të BE-së për IA-në ;
- Identifikimin e fushave të zbatimit dhe institucioneve përgjegjëse;
- Vlerësimin e ndikimit në legjislacionin ekzistues shqiptar;
- Propozimin e masave për transpozimin dhe implementimin e këtij akti në kuadrin ligjor kombëtar;
- Konsultimin me palët e interesuara.

Një grup pune ndërinstitutional¹⁸ është në proces dhe projekt vendimi për ngritjen e këtij grupi pune është në fazë përfundimtare miratimi. Grupi i punës do të ketë për detyrë të:

¹⁵ Regulatory sandboxes për Inteligjencën Artificiale janë mjedise të kontrolluara testimi ku inovatorët mund të zhvillojnë dhe provojnë zgjidhje të reja të IA-së nën mbikëqyrjen e autoriteteve rregullatore, pa rrezikuar shkeljen e ligjeve ekzistuese. Ato synojnë

¹⁶ [https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/mpo/2025/3/working-party-on-enlargement-and-countries-negotiating-accession-to-the-eu-\(352584\)/](https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/mpo/2025/3/working-party-on-enlargement-and-countries-negotiating-accession-to-the-eu-(352584)/)

¹⁷ <https://www.kryeministria.al/newsroom/hapen-negociatat-per-kapitujt-e-grupimit-3-konkurrueshmëria-dhe-rritja-gjithëpërfshirëse/>

¹⁸ Përgjigje nga AKSHI ndaj kërkesës për informacion të SCiDEV, datë 08.09.2025

- Të analizojë përmbajtjen e Aktit të BE-së për IA-në;
- Të përcaktojnë fushat prioritare të transpozimit;
- Të koordinojnë institucionet përgjegjëse;
- Të propozojë aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) me Ministria e Ekonomisë dhe Energjisë (MIE) si për të gjitha aktet dhe proceset që lidhen me Kapitullin 10 “Transformimi Digjital dhe Media”, kanë rolin drejtues dhe koordinues, në cilësinë e bashkënegociatorëve të Kapitullit. AKSHI si institucioni propozues ka rolin kryesor në zbatim të Ligjit nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, si dhe në zbatim të Agjendës Digjitale të Shqipërisë 2022 – 2026.¹⁹

AKSHI bën të ditur se është duke ndjekur një proces të strukturuar për përafrimin e kuadrit ligjor shqiptar me Aktin Evropian për Inteligjencën Artificiale, i cili përfshin ngritjen e një grupi pune të posaçëm, përkthimin dhe përshtatjen e acquis-it të BE-së përmes platformës PIEA (Platforma e Integritimit Evropian për Përafrimin e legjislacionit), si dhe sigurimin e mbështetjes teknike nga instrumenti TAIEX i Bashkimit Evropian për ekspertizë dhe asistencë institucionale. Sipas AKSHI-t, procesi parashikohet të zhvillohet gjatë 2026 dhe të përfundojë me miratimin e projektligjit nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi.²⁰ Në këtë fazë, procesi është kryesisht normativ dhe i orientuar drejt harmonizimit formal me acquis-in e BE-së, ndërsa mbeten për t’u adresuar në mënyrë konkrete mekanizmat e zbatimit, mbikëqyrjes dhe garantimit të të drejtave themelore në përdorimin e IA-së në qeverisje.

3.2 Praktikë aktuale të përdorimit të AI në Shqipëri

Edhe pse në mungesë të një kuadri ligjor të detyrueshëm, të plotë dhe të qartë, dhe të pabarmonizuar ende me legjislacionin e BE-së, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një seri iniciativash për përdorimin dhe zhvillimin e teknologjive të IA-së në qeverisje. AKSHI është institucioni lider në zhvillimin strategjik dhe praktik të IA-së në vend. AKSHI është autorizuar të nënshkruaj Marrëveshjen e Partneritetit Strategjik me Shoqërinë “Microsoft Corporation”, me datë 27.0.2024, me fusha të bashkëpunimit potencial²¹:

- Strategjia për ndërmarrjet dhe planifikimin e TI-së;
- Arritjen e qëllimeve të Këshillit të Ministrave, duke maksimizuar vlerën nga investimet e teknologjisë për të shpalosur novacionin për qytetarët, bizneset dhe nëpunësit civilë;
- Shërbimet Këshillimore të Microsoft-it;
- Projekte të IA-së për nisma dixhitale.

Tabela 1: Integritet e IA-së në Shqipëri, sipas pasqyritimit në draft strategjinë e Inteligjencës Artificiale

¹⁹ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/06/01/370/8fd7b0cf-6848-431f-8bcb-5d08d16deaa7>

²⁰ Sipas komenteve të dorëzuar nga AKSHI grupit kërkimor pas konsultimit të draft dokumentit.

²¹ Përgjigje nga AKSHI ndaj kërkesave për informacion të SCiDEV dhe KShH, datë 16.10.2025

Zgjidhja IA	Përshkrim
Integrimi i IA-së në administratën publike përmes “Diella” – asistentit virtual të e-shërbimeve në e-Albania	“Diella”, asistenti virtual i lançuar në e-Albania në fund të vitit 2023, ka integrim audio dhe video dhe udhëzon qytetarët për të marrë shërbime elektronike. Diella do të plotësojë aplikimet online përmes bisedave të thjeshta me zë, duke e kthyer ndërveprimin me shtetin në një proces natyral – duke reduktuar ndërhyrjen e njeriut dhe kohën e pritjes, ndërsa rrit ndjeshëm efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit.
Integrimit të IA-së në Administratën Publike përmes Modullit të IA-së për Përshtatjen e Legjislacionit të BE-së me Legjislacionin Shqiptar	Për të përshpejtuar dhe modernizuar procesin e përafrimit legjislativ është integruar IA-ja në Platformën e Integrimit Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA), duke automatizuar funksione kyçe. Me anë të AI-së mundësohet: i. Përkthimi automatik i akteve ligjore me saktësi mbi 97%; ii. Analizim dhe identifikim të mospërputhjeve me legjislacionin shqiptar; iii. Gjenerim automatik i tabelës së përputhshmërisë; iv. Monitorim në kohë reale i procesit të përkthimit dhe përafrimit; v. Lejimi të përmirësimeve manuale nga ekspertët, duke kombinuar fuqinë teknologjike me vendimmarrjen njerëzore me qëllim verifikueshmerinë dhe ruajtjen e përgjegjësisë mbi përdorimin e modeleve AI.
IA-ja në mbivendosje legjislacioni	Zhvillimi i Sistemit të Mbivendosjes Ligjore ka në fokus krijimin e procesit analitik për zbulimin automatik të mbivendosjeve ndërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, ku janë integruar mekanizma të avancuar për identifikimin e konflikteve normative. Zgjidhja është ndërtuar në mënyrë që të mundësojë analizimin e të gjitha akteve ligjore të miratuara dhe të publikuara në Qendrën e Botimeve Zyrtare (QBZ). Aktualisht, sistemi ka kapacitet të plotë për të trajtuar çdo ligj të disponueshëm në QBZ, duke siguruar zgjerim gradual të analizës pa kufizime në fushën e legjislacionit.
IA-ja në analizën fiskale, lufta kundër evazionit fiskal (tatime/dogana)	Sistemi i detektimit të anomalive në sistemin e fiskalizimit ka në fokus zhvillimin e një modeli inteligjent për analizën fiskale dhe identifikimin e transaksioneve anormale në sistemin e fiskalizimit elektronik (eIAD). Zhvillimi i këtij sistemi përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së efikasitetit të mbikëqyrjes financiare, përmes integrimit të

	teknologjive të avancuara të “Big Data” dhe mësimi të makinerive (Machine Learning). Në fazën e parë, modeli është ndërtuar për identifikimin në kohë reale të transaksioneve të dyshimta, duke rritur transparencën dhe efikasitetin operacional. Në fazën e dytë, projekti është zgjeruar me fokus në analizën e sistemit të pagave dhe tatimeve mbi të ardhurat personale.
--	--

Për integrimet e mësipërme, AKSHI shprehet se janë në përputhje me parashikimet e Metodologjisë për Standardet Teknike në Përdorimin e Inteligjencës Artificiale në Republikën e Shqipërisë. Në kuadër të detyrimeve që rrjedhin dhe nga Metodologjia, për integrimin e AI-së janë ndërmarra masa ku përfshihen:

- Vlerësimin paraprak të ndikimit etik dhe ligjor (AI Impact Assessment) për çdo zgjidhje, në përputhje me parimet e transparencës, drejtësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale;
- Klasifikimin e rrezikut të sistemeve të AI-së, sipas metodologjisë së riskut të përcaktuar në standardet kombëtare, duke përcaktuar masat përkatëse të kontrollit dhe monitorimit;
- Ruajtjen e sovranitetit të të dhënave, përmes përdorimit të infrastrukturave cloud të certifikuara dhe të kontrolluara nga shteti;
- Dokumentimin teknik dhe operacional të çdo faze të zhvillimit, për të siguruar auditueshmëri të plotë dhe përputhshmëri me kërkesat e qeverisjes etike të AI-së.

Megjithatë, vlerësimet paraprake të ndikimit etik dhe ligjor për zgjidhjet e sipërpërmendura nuk janë bërë publike. Autorët nuk arritën të gjejnë informacion për klasifikimin e risqeve të këtyre zgjidhjeve. Sa i përket buxhetit apo kosteve të zgjidhjeve IA të implementuara, AKSHI nuk i ka vënë në dispozicion të ekipit kërkimor, duke argumentuar se përfshin informacion të klasifikuar dhe se është vështirë të izolohen kostot e komponentëve IA pasi janë pjesë e projekteve të mëdha digjitale multifunksional.²² AKSHI argumenton se do sigurojë transparencë përmes publikimit të raporteve periodike mbi kostot, procedurat e vlerësimit të riskut dhe rezultatet e implementimit të projekteve të IA-së.²³

Ministri i Shtetit– Diella

Më 11 shtator 2025, Kryeministri i Shqipërisë, gjatë Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste, njoftoi krijimin e një ministrije të re të shtetit të fuqizuar nga IA-ja, të quajtur “Diella.”²⁴

Gjatë prezantimit Kryeministri theksoi: “Ajo [Diella] nuk do të jetë fizikisht e pranishme, por e krijuar virtualisht nga inteligjenca artificiale; do të ketë mbështetjen e një strukture të posaçme për adoptimin e inteligjencës artificiale në proceset qeveritare, si edhe një mandat të veçantë për

²² Sipas komenteve të dorëzuar nga AKSHI grupit kërkimor pas konsultimit të draft dokumentit

²³ Sipas komenteve të dorëzuar nga AKSHI grupit kërkimor pas konsultimit të draft dokumentit.

²⁴ <https://www.kryeministria.al/ministrat/diella/>

të thyer barrierat e paragjyimit, frikës dhe, mbi të gjitha, ngurtësisë së administratës. Dhe për të ndikuar sa më fort në ritmin e proceseve qeveritare.”²⁵

Në 12 shtator 2025, Presidenti i Republikës së Shqipërisë shpalli dekretin e emërimit të Kryeministrit. Ky dekret, si nen të dytë kishte dhënien e kompetencave Kryeministrit për të *ushtruar edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e Ministrisë Virtual të Inteligjencës Artificiale “Diella”*²⁶. Deri më tani, ky është i vetmi dokument publik, që tenton institucionalizimin e ministrit virtual të IA-së.

Diskutime për ligjshmërinë e këtij vendimi, konceptit të një ministri gjeneruar nga IA-ja, si dhe për kapacitetet teknike të realizimit të kësaj zgjidhje janë ngritur edhe pse mungojnë përgjigjet e plota dhe shteruese nga ana e Qeverisë. Përveç videove të avatarit Diella në dalje publike, nuk ka ndonjë zhvillim rregullator për ushtirimin e kompetencave të ministrit virtual, apo si do të ushtrohen këto kompetencave brenda hapësirave të njohura nga ligji shqiptar.

Përdorimi i teknologjive IA në monitorimin e territorit

Në prill të vitit 2025 u ratifikua marrëveshja e huas mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim të Abu Dhabit për financimin e projektit “Sistemi i Kamerave nën Administrimin e Policisë së Shtetit – SMART City”.²⁷ Ky projekt, me vlerë USD 118,500,000, dhe normë interesi 4% në vit mbi shumën e principalit të huas së tërhequr dhe të pashlyer, synon të forcojë infrastrukturën teknike në Republikën e Shqipërisë, për të garantuar një mjedis të sigurt dhe inteligjent, duke përfutur nga teknologjitë e inteligjencës artificiale²⁸. Projekti përfshin sigurimin dhe instalimin e platformave të inteligjencës artificiale për menaxhimin e qytetit dhe trafikut.

Në përgjigje të një kërkesë për informim dërguar nga SCiDEV në mars të vitit 2025 pranë Ministrisë së Brendshme, kjo e fundit konfirmoi se do të instalohen 2,239 kamera ANPR (njohje automatike e targave) dhe 2,602 kamerave PTZ për monitorimin e trafikut dhe identifikimin e shkeljeve. 12 qendra të monitorimit do të vendosen në drejtoritë e policisë. Përgjigja gjithashtu përmend se do të *integrohen dhe monitorohen 2,000 kamera ekzistuese në lokacione si shkolla, qendra tregtare, etj., për sigurinë publike*.

Në shkurt të vitit 2025, qeveria shqiptare, përmes Ministrisë së Brendshme, nënshkroi një letër angazhimi për Projektin Albania Smart City, me Presight AI Ltd një kompani me bazë në Emiratet e Bashkuara Arabe, e angazhuar në inteligjencë artificiale, analizë të dhënash, dhe shërbime të transformimit digjital.

Në të njëjtën përgjigje, Ministria e Brendshme shprehet për *garantimin e sigurisë së të dhënave përmes zbatimit të masave të forta mbrojtëse për të parandaluar aksesin e paautorizuar, keqpërdorimin apo rrjedhjen e informacionit të ndjeshëm*. Gjithashtu, *përdorimi i inteligjencës artificiale gjatë monitorimit për analizimin e sjelljes së mjeteve dhe individëve me qëllim parandalimin apo reduktimin e numrit të aksidenteve rrugore, do të jetë gjithnjë në përputhje me të drejtat e individëve*. Kërkesës për informacion të SCiDEV dhe KShH për fazën ku ndodhej

²⁵ <https://ata.gov.al/2025/09/11/diella-e-krijuar-nga-inteligjenca-artificiale-ministre-shteti-e-prokurimeve-publike/>

²⁶ Presidenti i Republikës së Shqipërisë. (2025, 12 shtator). *Presidenti Begaj dekreton emërimin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë* [Njoftim për shtyp].

²⁷ <https://www.kryeministria.al/newsroom/projektligje-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-28-shkurt-2025/>

²⁸ Fletore Zytrate (Viti 2025 – Numri 63), faqe 7492.

përdorimi i IA-së për analizën e të dhënave të mbledhura nga kamerat në kuadër të projektit “Smart City” ministria iu përgjigj se aktualisht është në procesin e hartimit të projektit dhe shqyrtimit të draft-kontratës së propozuar.

Në aspektin ligjor dhe të qeverisjes, projekti nënvizon domosdoshmërinë e një qasjeje të kujdesshme dhe të balancuar midis inovacionit teknologjik dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të individit. Përfshirja e teknologjive të IA-së në sistemet e kërkon standarde të qarta për përpunimin e të dhënave, transparencë mbi partneritetet teknike dhe garanci për mbikëqyrje të pavarur.²⁹ Mungesa e publikimit të detajeve për kontratën, specifikimet teknike dhe mënyrën e ruajtjes apo përdorimit të të dhënave ngre nevojën për një debat të hapur publik dhe për forcimin e mekanizmave ligjorë që sigurojnë proporcionalitet, përgjegjshmëri dhe respektim të plotë të parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

Përdorimi i IA-së në përpunimin e pamjeve të gjeneruara nga kamerat e cilësisë së lartë, rrit rrezikun e survejimit për qytetarët shqiptarë. Institucionet nuk japin një vlerësim të nivelit të riskut të përdorimit të ketyre sistemeve, pavarësisht parashikimeve të Metodologjisë. Kjo transparencë e ulët, në mos e munguar, në kombinim me potencialin e survejimit të sistemeve të kamerave lehtësuar nga IA-ja, sjell shqetësime serioze për mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetareëve, demokracisë dhe shtetit ligjor.

²⁹ <https://balkaninsight.com/2025/02/03/albanian-smart-city-deal-with-uae-firm-flagged-as-serious-surveillance-risk/>

IV. REGULLIMI I SISTEMEVE TË INTELIGJENTËS ARTIFICIALE NË BASHKIMIN EUROPIAN

4.1 Pikënisja për rregullimin e IA-së në BE

Rregullimi i përdorimit të sistemeve të IA-ve ka nisur në 2018 me krijimin e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për IA-në ("HLEG"), qëllimi i të cilit ishte miratimi i një instrumenti ligjor për IA-në, si një përparësi kryesore në agjendën e politikave të BE.³⁰ Në vitin 2020, ky Grup publikoi dokumentin politik orientues (the Ëhite Paper on AI) mbi IA-në, i cili shtroi për konsultim me grupet e interesit se cila do të ishte politika më e mirë mbi rregullimin e IA-së dhe rezultoi në prezantimin e draftit të parë, i cili përcakton rregullat kryesore të përdorimit të sistemeve IA,³¹ dhe sot përbën Aktin e BE-së për Inteligjencës Artificiale.

Akti i Inteligjencës Artificiale (AIA) nuk mundëson vetëm rregullimin e përdorimit të gjërë të sistemeve të IA-së, por siguron gjithashtu rritjen së besimit në këto sisteme dhe thekson nevojën thelbësore që këto sisteme të jenë të bazuara në vlerat dhe të drejtat themelore të njeriut siç janë dinjteti njerëzor, mbrojtja e privatësisë, mosdiskriminimi, liria e shprehjes dhe duke u fokusuar në mitigimin e rreziqeve që mund të sjellë përdorimi i tyre. Rregullimi i IA-ve të besuara dhe të sigurta do të ishte një indikator i rëndësishëm për të arritur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe për të çuar përpara Axhendën 2030 e prezantuar nga Presidentja e Komisionit Evropian.³²

Nëpërmjet analizës së Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për IA-në ("HLEG"), një vëmendje e veçantë iu kushtua dhe dëmit që mund të sillte përdorimi i sistemeve të IA-ve, dëmet këto si materiale ashtu edhe ato jomateriale. Dëmet kryesore materiale që shtetet dhe ofruesit e IA-ve duhet të kenë në vëmendje, lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të individëve, ku përfshihet humbja e jetës dhe dëmtimet e mundshme të pasurisë, ndërsa dëmet jomateriale parashikojnë humbjen e privatësisë, kufizimet e të drejtës së shprehjes, dinjteti njerëzor, diskriminimi, sidomos në kushtet e aksesit në punësim, të cilat mund të lidhen me një gamë të gjerë rreziqesh që mund të vijnë nga përdorimi i sistemeve IA të parregulluara.³³ Ndërkohë që një analizë e tillë nuk është publikuar me metodologjinë dhe standardet teknike të përdorimit të sistemeve IA.³⁴

Është e rëndësishme të theksohet se rreziku kryesor i parashikuar nga Akti i IA-së lidhet me cënimet e të drejtave të njeriut dhe me çështje që lidhen me sigurinë kibernetike në aplikimin e

³⁰ AI for Europe, COM/2018/237 final

³¹ COM(2020) 65 final. European Commission. (2020). WHITE PAPER On Artificial Intelligence - A European approach to excellence and trust

³² Presidentja Ursula Von der Leyen, A Union that strives for more – My agenda for Europe, faqe 17.

³³ Ibid, faqe 10.

³⁴ Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2024, 24 korrik). Vendim nr. 479, datë 24.7.2024, për miratimin e dokumentit të metodologjisë dhe standardet teknike për përdorimin e inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë.

IA-ve në infrastrukturat delikate si mbrojtja, shëndeti etj., si dhe përdorimi i këtyre sistemeve me qëllime keqdashëse.

4.2 Mbi Aktin e Bashkimit Evropian për Inteligjencën Artificiale

Akti i IA-së, i miratuar në dhjetor 2023, ka hyrë pjesërisht në fuqi më 1 gusht 2024 dhe hyn plotësisht në fuqi në 2 gusht 2026 dhe në vitin 2027, kur kjo rregullore do të jetë plotësisht e zbatueshme. Akti i IA-së përcakton katër objektiva kryesore, duke bërë të mundur që përdorimi i sistemeve në tregun e BE-së të jetë i sigurt dhe të respektojë të drejtat themelore, si dhe të garantoj ruajtjen e sigurisë juridike dhe zbatimin efektiv të legjislacionit në fuqi. Kjo rregullore ka për qëllim të zhvillojë një treg ku të mund të ofrohen sisteme IA-je të besueshme dhe me në qendër njeriun (“njeriu mbi çdo gjë”).³⁵

Bazuar në këto objektiva dhe gjithashtu duke pasur si qëllim rregullimin në nivel Unioni të sistemeve të IA-ve, duke shmangur fragmentizimin dhe divergjencat, kjo rregullore përcakton qartë dhe klasifikon sistemet e IA-së duke miratuar një qasje të bazuar në vlerësimin e rrezikut që ky sistem paraqet dhe duke shkuar deri në ndalimin e praktikave të caktuara të inteligjencës artificiale.³⁶ Këtë rregullim e gjejmë edhe në metodologjinë dhe standardet teknike të përdorimit të sistemeve IA në Shqipëri.³⁷ Akti i IA-s gjithashtu parashikon se sistemet e IA-ve të cilat paraqesin risqe të papranueshme duhet të ndalohet ndërsa ato me risqe të mëdha duhet të monitorohen dhe operatorët duhet të përcaktojnë kriteret në mënyrë sa më transparente.³⁸ Këtë klasifikim e gjejmë edhe në metodologjinë shqiptare, por pa parashikuar se çfarë do të ndodhë ose si do të bëhet vlerësimi i rrezikut të këtyre sistemeve, sikundër rezulton në rastin e rregullores së BE-së. Mungesa e këtyre përcaktimeve në një realitet ku zhvillimi dhe përdorimi i IA-së po zhvillohet vrullshëm, sjell domosdoshmëri adresimin e përkohshëm të masave mitiguese.

Rregullorja e BE-së për IA-në, e bazuar në vlerësimin e rrezikut, përqendrohet në ndikimin negativ mbi të drejtat themelore. Qëllimi i saj është të verë fokusin rregullator drejt sistemeve të IA-së me rrezik të lartë, duke i dalluar ato nga ato për të cilat mjaftojnë masat vullnetare në vend të atyre të detyrueshme. Ky kuadër thekson rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave themelore për të nxitur besimin në sistemet e IA-së.³⁹ Kjo rregullore parashikon se sistemet me rrezik të lartë duhet të plotësojnë një numër të caktuar kërkesash: të monitorojnë të gjithë ciklin, të trajtohen dhe të testohen me sete të dhënash të përshtatshme për këtë qëllim, të jenë të shoqëruara nga një dokumentacion teknik dhe informacion për zbatuesit rreth rreziqeve të mundshme, të lejojnë mbajtjen automatike të të dhënave të ngjarjeve të sistemit, t’i nënshtrohen mbikëqyrjes njerëzore

³⁵ Shih nenin 1 të Rregullores nr. 2024/1689 të BE “Akti i IA-së” dhe parimin 1.1 & 1.2 dhe kreun IV/1 të Vendimit nr. 479, datë 24.7.2024, për miratimin e dokumentit të metodologjisë dhe standardet teknike për përdorimin e inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë.

³⁶ Kusche, I. (2024). Possible harms of artificial intelligence and the EU AI act: fundamental rights and risk. *Journal of Risk Research*, 1-14.

³⁷ Shih Standartin 1.1/ Ç të Vendimit nr. 479, datë 24.7.2024, për miratimin e dokumentit të metodologjisë dhe standardet teknike për përdorimin e inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë.

³⁸ Shih Recitalin 31 & 179 e rregullores nr. 2024/1689 të BE “Akti i IA-së”

³⁹ Yordanova, K. (2022). The EU AI Act-Balancing human rights and innovation through regulatory sandboxes and standardization.

kur janë në përdorim dhe t'i nënshtrohen një procedure vlerësimi të përshtatshmërisë përpara se të vendosen në treg ose të vihen në shërbim.⁴⁰

Ndërsa metodologjia shqiptare parashikon se, për të përcaktuar llojin e sistemeve, veprimet që rekomandohen lidhen me hartimin dhe rishikimin e rregullt të politikave të dokumentimit, të cilat, midis të tjerave, adresojnë: informacionin mbi palët e interesit të IA-së, zbatimin dhe përdorimin e IA-së, rreziqet potenciale dhe ndikimin e mundshëm, kushtet paraprake dhe kufizimet, metodologjinë algoritmike, si dhe planet për monitorimin dhe menaxhimin e ndryshimeve. Të gjitha këto kriterë janë në nivel rekomandues dhe nuk parashikojnë një rregullim të qartë dhe të detyrueshëm të monitorimit të llojeve të sistemeve IA.⁴¹

4.3 Të drejtat themelore dhe rreziqet e përdorimit të sistemeve IA

Bashkimi Evropian ka qenë proaktiv në arritjen e objektivave që synojnë rregullimin e qeverisjen e sistemeve IA mbi baza etike. Në qendër të kësaj sipërmarrje është Akti i IA-së, megjithëse ka një kuadër ligjor të gjërë dhe mjete rregullatore, të cilat kontribuojnë në mbikëqyrjen e IA-së siç janë Akti i Tregjeve Dixhitale (DSA), Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR). Ndërsa zbatimi i Aktit të IA-së tashmë është një realitet në BE, ka shqetësim në rritje në lidhje me aftësinë parashikuese të IA-së për të ndihmuar vendimmarrjen dhe për ta zhvendosur atë nga të qenit e varur vetëm nga llogaritjet e automatizuara. Mbështetja në të dhënat dhe algoritmet e trajnimit, të cilat zgjidhen përmes proceseve të panjohura çon në rezultate (*bias*) të njëanshme dhe në vazhdimësinë e mundshme të padrejtësive historike në të ardhmen, të cilat mund të rezultojnë në përfundime diskriminuese.⁴²

Dokumenti politik orientues (Ëhite Paper) i Komisionit Evropian (2020) rendit *“humbjen e privatësisë, kufizimet e së drejtës së lirisë së shprehjes, dinjitetin njerëzor, diskriminimin, për shembull në aksesin në punësim”* si dëme të mundshme të IA-së, duke i ndarë ato si rreziqe jomateriale për të drejtat themelore nga rreziqet materiale për sigurinë dhe shëndetin. Ky reflektim është bërë në *recitalin 1* të Aktit të IA-së parashikon që demokracia, sundimi i ligjit dhe mjedisi të përfshihen në listën e subjekteve potencialisht në rrezik nga IA-ja.⁴³ Akti i IA-së i përcakton të gjitha dëmet e mundshme të sistemeve të IA-së si dëme ndaj një të drejte themelore dhe konfirmon një qasje të bazuar në rrezik ndaj rregullimit.⁴⁴

Si pasojë, të drejtat themelore bëhen referencë qendrore për vendimet ligjore, politike dhe të përditshme të marra nga individët që ndikohen nga sistemet e IA-së. Referenca e parë përmendet si pjesë integrale e kuadrit rregullator të Aktit të IA-së, ku ato dokumentohen jo si rregulla detyruese, por si parime udhëzuese që duhet të merren në konsideratë. Megjithatë, për të vlerësuar cenimin e të drejtave themelore nga zbatimi i sistemeve të IA-së, rregullorja nuk parashikon ndonjë dispozitë të veçantë, duke ia lënë këtë kompetencë institucioneve gjyqësore.

⁴⁰ Neni 9-16 i rregullores nr. 2024/1689 të BE “Akti i IA-së”

⁴¹ Shih standartin 1/B të Vendimit nr. 479, datë 24.7.2024, për miratimin e dokumentit të metodologjisë dhe standardet teknike për përdorimin e inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë.

⁴² Zajko, Mike. 2022. “Artificial Intelligence, Algorithms, and Social Inequality: Sociological Contributions to Contemporary Debates.” *Sociology Compass* 16 (3): E12962. <https://doi.org/10.1111/soc4.12962>.

⁴³ Recitali 1 i Rregullores nr. 2024/1689 të BE “Akti i IA-së”

⁴⁴ Recitali 14 i Rregullores nr. 2024/1689 të BE “Akti i IA-së”

Një tjetër element i rëndësishëm që kjo rregullore vë theksin është respektimi i të drejtave themelore gjatë krijimit të sistemeve të IA-së. Në rregullore, vlerat njerëzore janë të mbrojtura dhe janë gjithashtu pika referuese që justifikon në mënyrë implicite ose eksplicite vendimet për përfshirjen e llojeve të sistemeve të IA-së në kategorinë e rrezikut të lartë. Referimi i tretë i të drejtave themelore në këtë rregullore lidhet me pajtueshmërinë, të cilën rregullorja e paraqet si tregues besueshmërie. Ky indikator është tautologjik, sepse edhe pse ka sisteme të IA-së që potencialisht mund të cenojnë të drejtat themelore (*sistemet me rrezik të lartë*), rregullorja u lejon atyre të ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën monitorim. Megjithatë, rreziku për përdoruesit që vijnë nga përdorimi i një sistemi të IA-së mbetet i pranishëm, pavarësisht nëse ky sistem është në përputhshmëri me rregulloren apo jo dhe ruajtjen e standarteve të të drejtave themelore. Si rrjedhojë, besueshmëria mund të konsiderohet një rrezik i vazhdueshëm, gjë që është e papranueshme për ekzitencën e sistemit.

Rregullorja e re paraqet sistemet e IA-së të cilat paraqesin rrezeqe 'të papranueshme' dhe 'me rrezik të lartë' që mund të kenë një ndikim të dëmshëm në shëndetin, sigurinë ose të drejtat themelore të njeriut, janë të autorizuar, por të nënshtruara ndaj një sërë kërkesash dhe detyrimesh për të ushtuar veprimtarinë në tregun e BE-së. Sistemet e IA-së që paraqesin rrezeqe të kufizuara për shkak të mungesës së transparencës së tyre, parashikohet sipas rregullores që t'i nënshtrohen kërkesave të informacionit dhe transparencës, ndërsa sistemet e IA-së që paraqesin vetëm rrezik minimal për njerëzit nuk do t'i nënshtrohen detyrimeve të mëtejshme. Gjithashtu, Akti i IA-së përcakton rregulla specifike për modelet e IA-së për qëllime të përgjithshme (GPAI) dhe përcakton kërkesa më të rrepta për modelet GPAI me *'aftësi me ndikim të lartë'* që mund të paraqesin një rrezik sistematik dhe të kenë një ndikim të rëndësishëm në tregun e brendshëm.⁴⁵

Neni 27 i rregullores parashikon se: *"Para vendosjes në përdorim të një sistemi të inteligjencës artificiale me rrezik të lartë, të përmendur në nenin 6(2), me përjashtim të sistemeve të tilla të destinuara për t'u përdorur në fushën e listuar në pikën 2 të Aneksit III, përdoruesit që janë organe të së drejtës publike, ose subjekte private që ofrojnë shërbime publike, si dhe përdoruesit e sistemeve me rrezik të lartë të përmendura në pikat 5(b) dhe 5(c) të Aneksit III, duhet të kryejnë një vlerësim të ndikimit mbi të drejtat themelore që mund të prodhojë përdorimi i këtij sistemi."*⁴⁶ Vlerësimi i ndikimit mbi të drejtat themelore është një nga shtyllat kryesore të zbatimit të sistemeve IA dhe parashikohet edhe në nenin 35 të GDPR, i cili kërkon një vlerësim të ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale në skenarë kritikë. Megjithatë, ajo që mbetet e paqartë është mënyra sesi ofruesit e sistemeve IA mund të shkelin të drejtat themelore, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet gjenerimit të informacionit. Për më tepër, neni 9 i Rregullores parashikon një vlerësim të përgjithshëm të rrezikut, i cili përfshin dimensionet e të drejtave themelore, duke imponuar mbi ofruesit e sistemeve të IA-së detyrimin për të kryer një analizë të tillë gjithëpërfshirëse të riskut.⁴⁷

⁴⁵ Madiega, T. (2024, September). *Artificial intelligence act*.

⁴⁶ Shih nenin 27 të Rregullores nr. 2024/1689 të BE "Akti i IA-së"

⁴⁷ Hacker, P. (2024). AI regulation in Europe: from the AI act to future regulatory challenges. *Ifeoma Ajunwa & Jeremias Adams-Prassl (eds), Oxford Handbook of Algorithmic Governance and the Law*, Oxford University Press.

4.4 Konventa Kuadër e KiE-së për Inteligjencën Artificiale

Paralelisht përpjekjeve të BE-së për të rregulluar në mënyrë të harmonizuar përdorimin e inteligjencës artificiale, Këshilli i Evropës ka miratuar gjithashtu Konventën Kornizë mbi Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Sundimin e Ligjit,⁴⁸ duke nënvizuar angazhimin e Evropës për rregullimin e IA-së në një mënyrë që mbron vlerat themelore dhe siguron përdorimin e përgjegjshëm të teknologjive të reja. Kjo konventë aktualisht është nënshkruar nga Bashkimi Evropian dhe vende të tjera⁴⁹ duke e bërë kështu instrumentin e parë ndërkombëtar në këtë fushë. Ajo ka për qëllim të sigurojë që aktivitetet që përfshihen në një nga ciklet e sistemeve të IA-së të jenë në përputhje me shtetin e së drejtës, sistemet demokratike dhe të drejtat e njeriut. Qëllimi kryesor i konventës është plotësimi i standardeve ekzistuese të vendosura nga shtetet dhe institucionet ndërkombëtare, si edhe adresimi i çdo boshllëku ligjor përballë zhvillimeve teknologjike.

Konventa kuadër parashikon në mënyrë gjithëpërfshirëse një kornizë ligjore që udhëzon ciklin jetësor të sistemeve IA, duke u përqendruar në rreziqet e mundshme gjatë fazave të projektimit, vendosjes dhe çmontimit. Ajo zbatohet për të gjitha subjektet e përfshira me sistemet e IA-së apo ato subjekte të cilat veprojnë për llogari të sistemeve IA duke ofruar një mekanizëm kontrollues dhe duke promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar për të siguruar respektimin. Bazuar në këtë konventë, shtetet kanë dy mundësi: të zbatojnë drejtpërdrejt dispozitat e Konventës ose të hartojnë standarde alternative të harmonizuara me detyrimet e tyre ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit.

Konventa parashikon që sistemet IA duhet të jenë transparente dhe të kenë mbikëqyrje specifike, siç është shënimi i përmbajtjes së gjeneruar nga IA-ja. Kjo konventë vë theksin se përdoruesit janë përgjegjës për veprimet në sistemet e IA dhe këto sisteme duhet të funksionojnë në atë mënyrë që të ruajnë privatësinë dhe mos të jenë diskriminuese. Po ashtu si rregullorja e BE-së për IA-në, Konventa thekson nevojën për vlerësime të ndikimit mbi të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit, duke identifikuar disa aplikacione të IA-së si me flamuj të kuq për rreziqet e sigurisë kombëtare. Konventa detyron shtetet që e kanë ratifikuar me detyrimin pozitiv që të sigurojnë mjete ligjore të mjaftueshme për të vënë në vend ose të kompensojnë dëmet e shkaktuara nga përdorimi i sistemeve IA, në rastet kur janë shkelur të drejtat e njeriut dhe se këto shtetet duhet të garantojnë mbrojtje procedurale përfshirë edhe njoftimin e individëve, kur përdorin ose janë në ndërvëprim me një sistem IA.

Duhet theksuar e përpjekjet e KiE-së për të ofruar një instrument që vendos standartet e përdorimit të IA-ve dhe të drejtave të njeriut, nuk janë trajtuar nga institucionet ndërkombëtare si GjEDNJ apo Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale. Konventa e IA-së dhe parimet e KEDNJ-së ofrojnë udhëzime të forta për trajtimin e rasteve që lidhen me IA-në. Veçanërisht, GjEDNJ-ja më parë ka trajtuar çështje të reja të të drejtave të njeriut që lidhen me teknologjinë, siç janë sistemet e njohjes së fytyrës (*facial recognition*). Këto organe të KiE-së synojnë të mbështesin të drejtat e njeriut duke i mbajtur autoritetet kombëtare përgjegjëse dhe duke siguruar që mbajtësit e të drejtave të kenë mbrojtje të mjaftueshme përmes legjislacionit, burimeve, mekanizmave të

⁴⁸ Council of Europe, Framework Convention on Artificial Intelligence and Human Rights, Democracy and the Rule of Law (Sept. 5, 2024), <https://rm.coe.int/1680afae3c7>

⁴⁹ <https://www.coe.int/en/web/artificial-intelligence/the-framework-convention-on-artificial-intelligence>

pavarur si institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe koordinimit efektiv me organet e tjera kombëtare të të drejtave të njeriut.⁵⁰

Në komentet e përcjella nga AKSHI pas procesit të konsultimit të këtij dokumenti politikash, theksohet se Konventa ndodhet aktualisht në Kuvend për miratim. Megjithatë, autorët nuk kanë arritur të identifikojnë asnjë dokument zyrtar apo njoftim publik në faqen e Kuvendit që të dëshmojë ekzistencën apo ecurinë e këtij procesi ligjvënës. Po ashtu, nënshkrimi dhe ratifikimi i Konventës nuk janë të reflektuara në Draft Strategjinë për Inteligjencën Artificiale, e cila tashmë i është nënshtruar konsultimit publik. Kjo mospërputhje midis deklarimeve institucionale dhe dokumenteve strategjike në qarkullim sugjeron mungesë koherence në planifikimin politik dhe institucional. AKSHI konfirmon se ky element do të përfshihet dhe pasqyrohet në versionin përfundimtar të strategjisë.

⁵⁰ Steering Committee for Human Rights (CDDH), Drafting Group on Human Rights and Artificial Intelligence (CDDH-IA). (2025, March 12). *[Draft] Handbook on human rights and artificial intelligence: Chapters I, II and III* (CDDH-IA(2025)1REV). Council of Europe.

V. REKOMANDIME

Duke konsideruar zhvillimin aktual të deklaruar të zgjidhjeve të IA-së në qeverisje në Shqipëri dhe punën e sapo nisur për përafrimin e legjislacionit kombëtar me Aktin e BE-së për Inteligjencën Artificiale, lind domosdoshmeria e marrjes së masave tranzitore, afatshkurtra deri në hyrjen në fuqi të zgjidhjes ligjore për rregullimin e IA-së. Në këtë kuadër, rekomandimet e mëposhtme janë strukturuar për të adresuar këtë fazë tranzitore, dhe të ardhmen më të largët.

5.1 Masa tranzitore për rregullimin e IA-së në Shqipëri

Duke qenë se sistemet e IA-së po prokurohen dhe zbatohen tashmë në Shqipëri pa një kuadër të posaçëm ligjor, Qeveria duhet të miratojë një paketë masash të përkohshme urgjente për të parandaluar rreziqe ligjore, etike dhe të të drejtave të njeriut deri në përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar me aktin e BE-së për IA-në. Proaktiviteti i Qeverisë në ndërmarrjen e masave tranzitore në mbrojtje të të drejtave themelore të njeriut, deri në adoptimin e Aktit të BE-së për IA, është test kycc për ndërtimin e besimit, dhe sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies.

- Bërja publike e grupit të punës për përafrimin e legjislacionit me Aktin e BE-së për IA, zgjerimi i grupit me përfaqësues të institucioneve të Pavarura të të drejtave të njeriut (Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale), akademisë dhe organizatave të shoqërisë civile, si parakusht për të siguruar një proces gjithpërfshirës, transparent, dhe me fokus në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Auditimi i kontratave të deritanishme, si me Microsoft dhe Presight AI nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.
- Adoptimi i një metodologjie të ndërmjetme për kryerjen e Vlerësimit të Ndikimit mbi të Drejtat Themelore të sistemeve të IA-së, dhe të përfshihen klauzola të detyrueshme për transparencë dhe auditueshmëri në çdo kontratë ekzistuese, sipas parashikimeve të Aktit të BE-së për IA-në.
- Duke qenë se AKSHI është institucioni i mandatuar për zhvillimin dhe integrimin e IA-së në qeverisje, është e domosdoshme krijimi i një grupi ndërinstitutional, me pjesëmarrje edhe të Institucioneve të pavarura që mbrojnë të drejtat e njeriut dhe organizatave të shoqërisë civile, për të kontribuar në përgatitjen e Vlerësimeve të Ndikimit mbi të Drejtat Themelore të IA-ve.
- Nënshkrimi dhe Ratifikimi i Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale: Qeveria e Shqipërisë duhet të nënshkruajë dhe ratifikojë Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës, e cila do të përforconte kuadrin kombëtar të qeverisjes së IA-së duke vendosur bazat për respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, dhe duke garantuar që rregullimi i ardhshëm kombëtar të reflektojë vlerat demokratike dhe standardet ndërkombëtare evropiane.

- Implementimi i mekanizmave koordinuese mes ofruesëve të shërbimeve të IA-së, institucioneve që implementojnë teknologji IA, AKSK dhe AKSHI-t, për të siguruar që zgjidhjet aderjnë në standardet kombëtare të sigurisë kibernetike, me qëllim minimizimin e rrezikut të sulmeve kibernetike që mund të çojnë në cenimin e privatësisë së qytetarëve.
- Të sigurohet transparencë e plotë dhe vlerësim i sistematik i risqeve për të gjitha kontratat që lidhen me përdorimin e IA-së në qeverisje, përfshirë projektin “Smart City” dhe marrëveshjet e tjera ekzistuese me kompani vendase apo të huaja. Institucionet publike duhet të publikojnë në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme informacionin mbi objektin, kostot, partnerët zbatues, afatet dhe mekanizmat e mbrojtjes së të dhënave, duke garantuar një proces të hapur dhe të mbikëqyrur. Një vlerësim i plotë i risqeve ligjore, teknike, etike dhe institucionale duhet të shoqërojë çdo kontratë që përfshin përdorimin e IA-së, me qëllim forcimin e llogaridhënies publike, parandalimin e abuzimeve dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve në proceset e digitalizimit.

5.2 Masa afatgjata të qeverisjes së IA-së

Miratimi i kuadrit të plotë ligjorë dhe përafrimi i Aktit të BE-së për AI-në me proces të gjerë konsultimi, gjithëpërfshirje dhe transparencë

Të hartohet dhe të miratohet një kuadër ligjor i plotë, i qartë dhe gjithëpërfshirës për inteligjencën artificiale në Shqipëri, që garanton përgjegjshmëri, zbatim të detyrueshëm dhe siguri juridike. Harmonizimi me Aktin e IA-së të BE-së do të sigurojë koherencë me kornizën rregullatore evropiane, do të forcojë besueshmërinë institucionale dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe do të ndihmojë Shqipërinë të ndërtojë një sistem të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm qeverisjeje për inteligjencën artificiale. Kuadri ligjor duhet të parashikojë krijimin e autoritetit kompetent kombëtar për inteligjencën artificiale, me kompetenca të qarta mbikëqyrëse dhe rregullatore. Duhet të garantohet ngritja e databazës kombëtare të algoritmeve dhe sistemeve të IA-së, në përputhje me kërkesat e transparencës dhe mbikëqyrjes së parashikuara nga AI Act. Po ashtu, duhet të përcaktohet një mekanizëm i strukturuar koordinimi ndërinstitutional, përfshirë një bord këshillimor me pjesëmarrje të gjerë, për të siguruar zbatim koherent, llogaridhënie dhe mbrojtje efektive të të drejtave themelore.

Sigurimi i Koordinimit midis Qeverisjes së IA-së, Kibernetikës dhe Legjislacionit Digjital

Shqipëria duhet të krijojë Memorandume Mirëkuptimi (MoU) dhe Procedura Standarde Operimi (SOP) ndërinstitutionale për të garantuar koordinim të plotë midis kuadrit të ri për IA-në dhe legjislacionit ekzistues në fushën e sigurisë kibernetike dhe qeverisjes elektronike. Kjo përfshin përafrimin me Ligjin nr. 25/2024 për Sigurinë Kibernetike, Ligjin nr. 43/2023 për Qeverisjen Elektronike, dhe VKM nr. 479/2024. Fushat kryesore të integritetit duhet të përfshijnë protokolle të përbashkëta auditimi dhe inspektimi, një mekanizëm të unifikuar reagimi ndaj incidenteve që lidh Autoritetin për IA me CSIRT-in kombëtar, si dhe një sistem të përbashkët të klasifikimit të informacionit. Ky bashkërendim do të shmangë mbivendosjen rregullatore, do të rrisë elasticitetin institucional dhe do të sigurojë që rreziqet që lidhen me sigurinë e IA-së të trajtohen në kuadër të sistemit të gjerë kombëtar të sigurisë digjitale, në përputhje me Akti i BE-së për IA dhe Direktivën NIS2.

Hartimi i një Strategjie Kombëtare për të Ardhmen e Punës dhe Aftësive në Epokën e IA-së

Shqipëria duhet të zhvillojë një strategji kombëtare gjithëpërfshirëse për të adresuar ndikimin e IA-së në punësim dhe zhvillimin e aftësive. Strategjia duhet të përfshijë:

1. Një hartë kombëtare të profesioneve dhe sektorëve që ka më shumë gjasa të transformohen nga IA;
2. Reforma kurrikulare që integrojnë aftësitë digjitale dhe të IA-së nga arsimi fillor deri te arsimi profesional dhe universitar; dhe
3. Programe masive për aftësim dhe ri-aftësim të fuqisë punëtore ekzistuese, të mbështetura me mekanizma nxitës si “voucher-a kompetencash në IA”